REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 917/20
Datë/Datum. 17-11-2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEWE BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Zenel Hisenaj	*Data e autorizimit të ekspertit 11.11.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 18.11.2020*	Nr. i lëndës: 917/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.11.2020, **N.T.SH . " NODE TECH ", Rr. Xhavit Sylaj, 23000,** Suhareke ka parashtruar ankesë me nr: 917/20, kundër njoftimit për të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizimi me paisje teknologjike(Komjutera ,komplet,fotokopje ,kamera te sigurise ,printera,videoprojektore dhe paisje tjera**" me nr. të prokurimit: **624-20-5060-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA SUHAREKË**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, , lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **30.000,00** €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE – N.T.SH . " NODE TECH "

AK Komuna e Suharekës me date 29.10.2020 na ka informuar përmes platformës se ka shpërblyer me kontrate një OE I cili është dukshëm me I shtrejt se oferta jone, ne vlere prej 4,942.50 euro
AK komuna Suhareke, na ka eliminuar për dy arsye:

1. Kerkesa1- Kërkesa1- Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve.

Për këtë pikë ne kemi ofruar dëshmi Listën e projekteve dhe referencat dhe Referencat ne vlerën: 155,624.80 euro d.m.th. ne kemi ofruar shume me shume dëshmi se sa është kërkuar, nëse për AK është

diçka e pa kjarte ne listën dhe dëshmi conform nenit 72 te LPP-se është dashur me kërkua sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej: 4,942.50 euro.

2. Kërkesa2 - Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku -Një(1) Inxhinier te elektronikes, se paku 3 vite përvojë pune pas Diplomimit.

Ne këtë pike fillimisht nuk keni kërkuar Inxhinier te diplomuar, po vetëm inxhier, përkundër kësaj për këtë pike ne kemi ofruar MASTER, z. Xhevat Berisha I cili me dëshmitë e tije I plotëson kërkesat e FDT-se. NE CV ju e keni vërejtur se ky inxhinier është Master, figuron ne liste siç është kërkuar, nëse e keni patuar te pa qarte dhe këtë pike është dashur conform nenit 72 te LPP-se te kërkoni diplomën Master te cilën po ua ofrojmë me këtë kërkesës për sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej 4,942.50 Euro

Pas kërkesës per rishqyrtim nga ana jone, për piken e inxhinier te elektronikes për te cilën jemi eliminuar, çuditërisht ne Vendimin e datës 06.11.2020 AK ka cekur se na mungon Inxhinier I Shkencave Kompjuter, për te cilën pike ne kemi ofruar stafin dhe dëshmitë e për te cilën vete AK nuk ka kemi eliminuar, sepse dëshmitë janë pjese e ofertës tone!!!

Përmbledhja:

1. Ne dëshmitë e ofruar për referenca mund te ekzistoje ndonjë gabim teknik I lëshuar nga institucionet te ndryshme për te cilat ne nuk duhet te paralizohemi, por te njëjtat mund te sqarohen conform nenit 72 te LPP-se, e po ashtu AK mund te mos I merr fare parasysh ato referenca sepse ne kërkesat e FDT-se I plotësojmë dhe me kontrata dhe referenca te tjera te cilat janë ne liste te dorëzuar e po ashtu te bashkangjitur me dëshmi/REFERENCA. Vlera e kërkuar nga AK është vetëm 45,000.00 Euro te cilën ne e plotësojmë me referenca (shiko listën e Kontratave dhe REFERENCAVE)
2. Inxhinieri I kërkuar me FDT është Master sic ne e kemi cek ne CV, nëse nuk e pas te qarte se a është Bachelor apo Master është dashur me kerku sqarime e jo me na eliminu. Kërkesa e AK për inxhinier ne këtë rast është kane kërkesa konfuze sepse nuk e ka cek as Bachelor e as Master, megjithatë ne e kemi Master dhe I kemi ofruar dëshmitë.
3. Keni parasysh me këtë vlerësim AK e ka Dëmtuar Buxhetin për: 4,942.50 euro
4. Ne njoftim për kontrate e ke cekur se afati është shkurtuar për shkak se shkolla ka fituar Donacion, I cili lidhet me këtë Projekt, ndërsa AK pikërisht e ka bere te kundërte qe ka shkruar ne njoftim, sepse me dhënien e tenderit ofertuesit me te shtrenjtë ka dëmtuar buxhetin dhe na ka shtyrë ne te ankohemi e kjo si gurishtë se do te merr kohe, d.m.th. nuk flitet për shkurtim afati.
5. Neni 6 I LPP-se(Ekonomistet dhe Efikasiteti) thotë:
   Te gjitha autoritet Kontraktuese, janë te obliguar qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit AK nuk e ka respektuar këtë NEN, me referenca prej mbi 170,000.00 Euro ka thënë nuk e përmbushin këtë kërkesë, dhe me inxhinier Master ka thënë se nuk e përmbushni kërkesën e FDT-se d.m.th. komplet ka vepruar kundërti ketin neni dhe arsyetimi është vetëm sa me thane diçka!!! Po ashtu vendimi pas kërkesë për shqyrtim tash flet për një staf tjetër, jo inxhinier te elektros, por te shkencave kompjuterike! Qe te dy I kemi me MASTER me te gjithë dëshmitë e kërkuara.
6. Duke e analizuar këtë procedure kemi vërejtur se qe ne fazën e tenderim AK ka bere shkelje ligjore sepse ne Specifikimet teknike ka përmendur EMRA te Prodhueseve e kjo është ne kundërshtim me LPP-ne sepse ne pozicionet 11 dhe 13 ka përmendure prodhuesin HIKVISION-c
   Neni 18.13 I RRUOPP-se e ndalon këtë qeshtje " asnjë specifikim nuk do te lëshohet me reference ngaj një marke te caktuar tregtare, emër te brendit, patente, dizajn lloj, origjine specifike, prodhues, katalog ose artikull me numër

7. Po ashtu gjate vlerësimit AK nuk na ka trajtuar barabartë siç thotë neni: Neni7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi, sepse për me na eliminua ne si OE me çmimin me te ulet duke be shkelje ligjore, ka kontaktuar edhe kompaninë e sigurimit për sigurinë e dorëzuar nga ne, ndërsa njëjtë nuk ka vepruar me OE fitues, d.m.th. me çdo kusht është munduar me na eliminua.

Andaj bazuar ne shkeljet qe janë bere si me sipër kërkojmë nga ju qe te:

-Aprovoni Ankesën tone

Te ktheni lenden ne RIVLERESIM, sepse përveç se jemi OE I Përgjegjshëm kemi edhe Çmimin me te ulet, kriter ky I përcaktuar nga AK.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, nuk janë te njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Kërkesa1- Operatori ekonomik duhe ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 Neni 65.

1. Dëshmia1- Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes)

2. Kërkesa2 –Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës

2. Dëshmia2- Vërtetimi i ATK.

3. Kërkesa3-OE duhet ta siguroje AK se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë me nje dokuemtn te lëshuar nga Gjykata kompetente. Deshmia kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.

3. Dëshmia3- Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje)

4. Kërkesa4-OE duhet ta siguroje AK se ka kryer obligimet tatimore ndaj Komunes. Deshmia kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 90 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.	4. Dëshmia4- Vërtetimi nga Komuna. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken 2,3 dhe 4, i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	
1. Kërkesa1-Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje)	1. Dëshmia1- Çertifikata e regjistrimit te biznesit, se bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje).
2. Kërkesa2-Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshire ne certifikaten e biznesit (kopje)	2. Dëshmia2- Çertifikata e numrit Fiskal nëse nuk është e përfshire ne certifikatën e biznesit (kopje).
3. Kërkesa3- Çertifikata per Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje)	3. Dëshmia3- Çertifikata per Regjistrim në TVSH (kopje).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar::	
1. Kërkesa1- Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi të kënaqshëme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, ne tre vitet e fundit është jo më pak se 60,000.00 Euro.	1. Dëshmia1- Dokument nga banka për qarkullimin e OE ose pasqyrat e auditura financiare, ose deklaratat vjetore tatimore te dorëzuara ne ATK.
III.2.4) Përshtatshmëria profesionale:	
1. Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve,	1. Dëshmia 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit përkontrate ne vlerën prej se paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve.
2. Kërkesa 2 Kualifikimet shkollore dhe	2. Dëshmia 2 Te dorëzoni listën në

profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushen perkatese, se paku	origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, DHE dëshmitë e përfundimit Referenca t ose procesverbali et e pranimit teknik.
1.1. Një (1) Inxhinier te elektronikes a. se paku 3 vite përvoj pune pas diplomimit	Dëshmia2 - Kontratat e punës ose mareveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV.
1.2. Një Inxhinier te Shkencave Kompjuterike a. se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit	Dëshmia2 - Kontratat e punës ose mareveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV.
3. Operatori duhe te ofroje katalogje për produktet, origjina e produkteve duhet të jetë nga vendet e BE-së.	Dëshmia3 – Katalogjet ose Broshurat, deshmi mbi origjinen e produktit
4. OE duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001 2015	Dëshmia 4- Çertifikata ISO 9001 2015
5. Kërkesa 5- OE duhet të ketë staf teknik, se paku 3 punëtor.	Dëshmia 5- Lista e punëtorëve, kontratat e punës ose para kontratë.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni pasi vlerësoi ofertat elektronike i rekomandon ZP-se qe te shpalle fitues OE CIMI@ ELECTRONIC SH.P.K me qmim me te lire ne vlere prej 23,799,00

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "OE NODE TECH"

Pretendimin Ankimor 1.

Kerkesa1- Kërkesa1- Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve.
Për këtë pikë ne kemi ofruar dëshmi Listën e projekteve dhe referencat dhe Referencat ne vlerën: 155,624.80 euro d.m.th. ne kemi ofruar shume me shume dëshmi se sa është kërkuar, nëse për AK është diçka e pa kjarte ne listën dhe dëshmi conform nenit 72 te LPP-se është dashur me kërkua sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej: 4,942.50 euro.

Përgjigje ne pretendimin Ankimor 1.

Bazuar ne Ofertën e OE Node Tech përkatësisht Listës se Kontratave/referencave te ofruar rezulton se Kontrata e ofruar dhe Referencat e plotësojnë kriterin sipas dosjes se Tenderit.

Andaj konsideroi se ky pretendim është i Bazuar

Pretendimin Ankimor 2.

Kërkesa2 - Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku -Një(1) Inxhinier te elektronikes, se paku 3 vite përvojë pune pas Diplomimit.
Ne këtë pike fillimisht nuk keni kërkuar Inxhinier te diplomuar, po vetëm inxhier, përkundër kësaj për këtë pike ne kemi ofruar MASTER, z. Xhevat Berisha I cili me dëshmitë e tije I plotëson kërkesat e FDT-se. NE CV ju e keni vërejtur se ky inxhinier është Master, figuron ne liste siç është kërkuar, nëse e keni patuar te pa qarte dhe këtë pike është dashur conform nenit 72 te LPP-se te kërkoni diplomën Master te cilën po ua ofrojmë me këtë kërkesës për sqarime e jo me dëmtua buxhetin prej 4,942.50 Euro
Pas kërkesës per rishqyrtim nga ana jone, për piken e inxhinier te elektronikes për te cilën jemi eliminuar, çuditërisht ne Vendimin e datës 06.11.2020 AK ka cekur se na mungon Inxhinier I Shkencave Kompjuter, për te cilën pike ne kemi ofruar stafin dhe dëshmitë e për te cilën vete AK nuk ka kemi eliminuar, sepse dëshmitë janë pjese e ofertës tone!!!

Përgjigje ne pretendimin Ankimor 2.
Bazuar ne dokumentet e dosjes se Ofertës per z. Xhevat Berisha te njëjtit kane ofruar dokumentacion si: Diplome Bachelor i Shkenca te Inxhinierisë Elektrik ku i njëjti mbanë datën e diplomimit me date 03 dhjetor 2013 ne Departamentin Elektronike,

Bazuar ne kërkesat se dosjes se Tenderit: Kërkesa2 – Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku –Nje (1) Inxhinier te elektronikes, se paku 3 vite përvoj pune pas diplomimit Një (1) Inxhinier i shkencave kompjuterike ,se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia2 - Kontratat e punës ose marrëveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV. Rezulton se i njëjti nuk përmbush kërkesën e AK-se pasi nuk plotëson kriterin baze sepse ka **Gradën Bachelor dhe jo Inxhinier** ashtu siç edhe kërkohet ne Kërkesën e AK-se. Në lidhje me këtë pretendim Ankimore OE do te duhej te parashtronte kërkesë për sqarime shtese gjate fazës se Njoftimit për kontrate dhe jo vetëm pas vlerësimit te Ofertave. **Andaj konsideroi se ky pretendim është i paqëndrueshëm.**

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-se

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK Suharekë
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - OE N.T.SH "Node Tech"